

COVID-19

Informacion rreth shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve

Nën Modelin -Ligjet për Shëndetin dhe Sigurisë së Punëtorve, punëdhënësi juaj ka detyrën e kujdesjes për shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve të tyre dhe të tjerëve në vendin e punës.

Çfarë kanë nevojë të dijnë punëtorët?

Ju keni për detyrë të kujdeseni në mënyrë të përgjegjshme për shëndetin dhe sigurinë tuaj personale dhe të mos ndikoni negativisht në shëndetin dhe sigurinë e të tjerëve.

Ju duhet të ndiqni rregullat dhe udhëzime të arsyeshme që punëdhënësi juaj ka krijuar si përgjigje ndaj virusit COVID-19. Kjo përfshin nëse jeni duke punuar nga një vend tjetër pune, siç është shtëpia.

Ç' duhet të bëjnë punëdhënësit?

Punëdhënësi juaj duhet të identifikojë rreziqet që i kanosen shëndetit dhe sigurisë gjatë punës nga ekspozimi ndaj virusit COVID-19 dhe kudo që të jetë e mundur të vendosi kontrole të përshtatshme. Ata duhet të ndjekin udhëzimet e qeverisë duke përfshirë zbatimin e [distancës shoqërore](#) - dmth duke mbajtur gjithë personat në vendin e punës së pakut 1.5m fizikisht larg njëri tjetrit.

Rreziqet nga COVID-19 mund të jenë fizike ose edhe psiko-sociale.

Se çfarë ka mundësi punëdhënësi juaj të bëj për menaxhimin e rreziqeve nga ekspozimi ndaj virusit COVID-19 mvaret nga vendi i punës dhe puna që bëni. Punëdhënësi duhet të bisedojë me ju rreth planit që ka ndërmend.

Ata mund të:

- Marrin masa për të menjanuar kontaktin e afërt me persona të tjerë- të mbajnë çdo person në vendin e punës së pakut 1.5 m fizikisht larg njëri tjetrit.
- Të inkurajojnë secilin në vendin e punës të zbatojë [higjenë të mirë](#) duke siguruar akses në ambientet e duhura të higjenës për t'iu mundësuar punëtorëve të lajnë duart me sapun dhe ujë për të paktën 20 sekonda ose të përdorin lëngë me bazë alkooli për pastrimin e duarve.
- Ofrojnë akses për pajisjet të mbrojtjes personale
- Shtojnë pastrimin e ambientit të punës
- Kufizojnë aksesin e vendit të punës karshi njerëzve të tjerë
- Ju drejtojnë të punoni nga një vend tjetër, siç është shtëpia – të mbani në mend që kjo mund të ndryshojë, të shtojë apo të krijojë rreziqe në lidhje me shëndetin e sigurinë e punës

Çfarë duhet të bëj në se mendoj që jam infektuar me COVID-19?

Ju duhet::

- Ju duhet të [kërkoni këshilla mjekësore](#)
- Duhet të ndërprisni shkuarjen në punë
- T'i tregoni punëdhënësit sa më parë dhe t'i lajmëroni në se gjendja e juaj ndryshon, p.sh. në se konfirmohet që jeni infektuar nga virusi.

A mund ta ndërpres punën në se bëhet e rrezikshme?

Në se keni shqetsime rreth sigurisë suaj, bisedoni me punëdhënësin tuaj ose me përfaqësues të shëndetit dhe sigurisë (HSR – Health and Safety Representatives.)

Në disa rrethana punonjësit kanë të drejtë të ndalojnë apo të refuzojnë të bëjnë punë që janë me rrezik. Ju keni këtë të drejtë në se ekziston një shqetsim i arsyeshëm që do t'ju ekspozojë ndaj një rreziku serioz për shëndetin dhe sigurinë tuaj nga një rrezik i menjëhershëm dhe i pashmangshëm – kjo mund të përfshijë ekspozimin ndaj virusit COVID-19.

Nëse ju ndërprisni punën sepse është e rrezikshme, duhet t'i tregoni punëdhënësit sa më parë. Atëhere duhet gjithashtu të jesh i disponueshëm për të kryer punë të përshtatshme alternative, siç është të punosh nga shtëpia.

Më shumë informacion

Për informacion të mëtejshëm rreth shëndetit dhe sigursë në punë, shikoni faqen e internetit - [Safe Work Australia](#).

Për informacion rreth lejes tuaj dhe pagesave shikoni informacionin në faqen e internetit - [Fair Work Ombudsman](#)

Për Shëndetin, shikoni në - health.gov.au

Ju lutem vini re që modelin e ligjeve WHS- Work Health and Safety (Shëndeti dhe Siguria në Punë) janë zbatuar në të gjitha juridiksionet përveç shteteve të Viktorias dhe Australisë Perëndimore. Për informacione që janë specifike për vendin tuaj të punës, ju lutem kontaktoni [WHS përkatës](#).